



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 664, datë 02.11.2023

PËR

**DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË MUNDËSISË FIZIKE DHE MENDORE PËR
USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË GJYQTARIT NGA Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 90 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si edhe në vendimin e tij nr. 223, datë 08.05.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}” pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, në përfundim,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR